

Masat e Efiçensës së Energjisë në ndërtesat e banimit

Të ndërtosh një ndërtesë efiçente presupozon projektimin, procesin e ndërtimit të ndërtesës së re të termoizoluar dhe izolimin e asaj ekzistuese.



...një shtëpi e termoizoluar kërkon më pak energji për tu ngrohur se një shtëpi e patermoizoluar. Shtresa termoizoluese (masa efiçente) pengon kalimin e nxehtësisë...dhe si rrjedhim humbjen e saj.

Disa nga masat e Efiçensës së Energjisë janë:

- Termoizolimi i ndërtesës
- Dyer dhe dritare efiçente
- Ngrohje qendrore
- Ndriçim efiçent
- Paisje elektroshtepiake efiçente
- Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë

1. Sistemi i termoizolimitat e banimit

a) Ç'është sistemi i termoizolimit

Sistem Termoizolimi është quajtur "Izolimi termik i jashtëm apo i brendshëm i stukturave rrethuese të ndërtesës" dhe është sistemi më i përdorur sot tek ne.

Një termoizolim i përshtatshëm i mureve rrethuese të ndërtesës dhe çatisë tarracës mund të ulë konsumin e energjisë më shumë se 50%.



b) Funkzionet

Funksionet tipike të këtij sistemi izolues janë:

- Izolim pa ndërprerje nga i ftohti dhe i nxehti.
- Mbrojtje e fasadave nga agjentet atmosferik.
- Vendos në kushte më të mira ndaj lagështirës strukturat e ndërtesave.
- Jep kushte optimale, komforti dhe higjienike të hapsirave të banuara.

c) Përfitimet nga termoizolimi

Termoizolimi ka këto të mira:

- Ulje të menjëhershme të konsumit të energjisë dhe si pasojë edhe ulje të kostos për lëndën djegëse.
- Rritje të kushteve të komfortit në mjediset e brendshme të banimit.
- Eliminim të urave termike, (plasaritjeve, çarjeve) që janë shqetësuese për ambientin e brendshëm të banesave.
- Reduktim të lëndës djegëse që përdoret për ngrohjen qoftë lëndë e ngurtë, e gaztë apo e lëngët, e cila çon në uljen e emetimeve të CO2 dhe SO2 në atmosferë. Ky sistem termoizolimi kontribuon në mënyrë të vazhdueshme në zgjidhjen e problemeve të ndotjes së mjedisit edhe smogut.

2. Dritare - Dyer efiçente



Dritaret janë një element shumë i rëndësishëm i pjesës së jashtme të ndërtesës që mundëson ndriçimin e hapësirës së brendshme të saj. Ato, gjithashtu, mundësojnë kontakt vizual me mjedisin, thithje të energjisë diellore dhe ventilimin e hapësirave të saj.

a) Dritaret efiçente

Dritaret efiçente janë të prodhuara nga material duralumini ose plastike që kanë dy ose tre shtresa xhami me hapsirë ajri midis tyre.

b) Funkzioni

- Izolim pa ndërprerje nga i ftohti dhe i nxehti.
- Mbrojtje e fasadave nga agjentët atmosferik.

c) Përfitimet nga dritareve efiçente

- Dritarja efiçente kursen 25% të energjisë së humbur prej saj.
- Kjo, sepse transmetimi i nxehtësisë prej saj ulet 2 deri ne 3 here.
- Përmireson komfortin e brendshëm dhe rrit estetikën e pamjes së ndërtesës.

3. Ngrohja Qendrore



Zgjedhja e përshtatshme e ngrohjes, ventilimit dhe sistemit të ajrit të kondicionuar (HVAC) në ndërtesa varet nga nevojat dhe karakteristikat e zonës ku është vendosur ndërtesa dhe natyrisht nga kërkesat e banuesve të saj.

Kujdes:

Në projektimin e sistemit të ngrohjes nuk është e rëndësishme të rritim kapacitetin e sistemit në vlera tepër të larta për të përballuar nevojat, por duhet të zgjedhin një sistem të tillë kapaciteti i prodhimit të të cilit (kapacitetin për ngrohje) i plotëson nevojat aktuale të ndërtesës.

a) Përfitimet nga vendosja e ngrohjes qendrore

- Kursen energjinë e përdorur për ngrohjen e banesave dhe si rrjedhim dhe lëndën djegëse të përdorur për këtë qëllim. Që të kursehet energji duhet që këto sisteme të kenë kaldaja efiçente (me rendiment 80-90%), termoizolim të tubave përcjellëse dhe elemente kontrolli siç janë valvolat termostatike të vendosur në radiatore.

A e dini se instalimi i valvolave termostatike në radiatorët e ngrohjes e kursen energjinë e përdorur për ngrohje deri në 20%?



4. Ndrichim eficient



a) Çfare është ndrichimi eficient

Ndrichimi eficient është një nga masat që sjell kursime domethënëse në energjinë elektrike të përdorur për këtë qëllim në banesë Ndrichimi eficient do të thotë përdorim i llambave eficiente (fluoreshente) në vend të llambave inkandeshente.

b) Përfitimet

- Kursehet energji elektrike. Për të njejtën sasi ndrichimi një llambe jo eficiente me fuqi 100W i përgjigjet një llambe eficiente 20W. Pra kursimi i energjisë është 5 herë më i lartë kur në përdorim llamba eficiente.
- Kanë një jetëgjatësi të madhe që shkon në më shumë se 10,000 orë pune në krahasim me llambat jo eficiente te cilat kahe jetëgjatësi deri në 1,000 orë pune.

A e dini se përdorimi i një llampe eficiente kursehen energjinë elektrike deri në 80%?

Shënim:

"Logot "IFC dhe "IFC and globe" janë markime/shenja të aktivitetit të Korporates Financiare Ndërkombëtare.

"Kjo fletëpalosje përmban informacione mbi produkte të eficientës së energjisë të cilat ofrohen vetëm për arsye informacioni. Nuk nënkupton ndonjë rekomandim të IFC. IFC nuk paraqet apo shpreh ndonjë garanci mbi saktësinë, përbushjen apo vlefshmërinë e informacionit të paraqitur".

5. Paisjet elektroshtepiake eficiente



a) Përfitimet e përdorimit të paisjeve elektroshtepiake eficiente

- Paisjet elektroshtepiake eficiente përdorin më pak energji elektrike krahasuar me ato të përdorura deri më tani në banesat tona. Prandaj, kur krijohet mundësia të përdoren paisje elektroshtepiake eficiente. Sipas standarteve të sotme paisjet që i takojnë klasës A, A+, A++ janë paisjet më eficiente.



Paisjet e klasës A, A+, A++ janë paisjet më eficiente.

- Kursimi i energjisë elektrike nga Stand-by i paisjeve elektroshtepiake është 5-10% e konsumit vjetor të energjisë elektrike në banesa.

10. Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë

Përdorimi i një paneli diellor me sipërfaqe 3-4m² të instaluar në tarracën/çatinë e ndërtesës për ngrohjen e ujit sanitari kursen energjinë e përdorur për këtë qëllim me shumë se 60% të saj. Kjo përqindje varet nga kushtet klimatike të vendit. Sa më i madh të jetë numri i ditëve me diell dhe sa më i lartë të jetë rrezatimi diellor aq më e lartë është përqindja e ujit të ngrohur nga paneli.

- A e dini se vendi ynë ka më shumë se 240 ditë me diell dhe se përdorimi i panelit diellor për ujë të ngrohtë sanitar mbulon 60- 80% të nevojës për energji?

Eficienta e Energjise në Banesa

“ Ulni konsumin e energjisë dhe mbron mjedisin ”



Zyra e IFC për Shërbimet e Konsulentëve në Evropën Juglindore
Pr. Dëshmorit e 4 Shkurtit
Sky Tower, Kati 8 / 1
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 231 401
Fax: +355 42 231 280



In partnership with
The Republic of Austria
Ministry of Finance



Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku
"Masë Shantë"
Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@akbn.gov.al
Tel: +355 4 2245195
Fax: +355 4 2257382